				paraqitur prej jush, ju bëjmë me dije se Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë organizohet në disa njësi organizative, të cilat ndihmojnë në realizimin e misionit dhe funksioneve të saj. Këto njësi organizative organizohen dhe funksionojnë sipas parimit të unitetit, hierarkisë dhe llogaridhënies. Çdo njësi organizative i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe drejtimit nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në të njëjtën kohë, në mbështetje të nenit 204, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë përfaqëson Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në marrëdhënie me të tretët. Vendimet e marra nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë akte administrative, të cilat hartohen dhe dalin në bazë të një procedurë të mirëfilltë administrative sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe në ushtrim korrekt të autoritetit të dhënë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar dhe ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar për të nxjerrë aktin administrativ, si dhe njoftimin e subjekteve të interesuara. Në zbatim të parashikimeve të neneve 204, pika 1, shkronja "j", dhe 214, pika 7, shkronjat "a", "b" dhe "c", të ligjit nr. 115/2016 "Për		

				organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, shqyrton projektvendimin e inspektorit duke verifikuar respektimin e kërkesave lidhur me formën, plotësinë e përmbajtjes, përkimin e vendimit me praktikën e punës të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë e të gjykatave dhe vendos miratimin, kthimin e projektvendimit me propozimin për të bërë korrigjimet dhe plotësimet e nevojshme, ose ndryshimin e projektvendimit. Në të njëjtën kohë, zyrtarët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbartin detyrimin për të garantuar paanësinë në çdo vendimmarrje, pasqyruar kjo në një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore me detyrime ligjore specifike për të deklaruar dhe shmangur çdo pengesë ligjore apo situate konflikti interesi. Këto akte ligjore dhe nënligjore janë të njohura dhe të detyrueshme për zbatim nga të gjithë punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e veçanërisht inspektorët që trajtojnë ankesa apo realizojnë hetime disiplinore. Në kuadër të parimit të transparencës, ju bëjmë me dije që në faqen zyrtare të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë të publikuar emrat e inspektorëve të atashuar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Drejtësisë. Pretendimet ndaj secilit inspektor që lidhen me papajtueshmërinë apo pengesat ligjore për kryerjen e detyrës gjatë një procedure administrative, bashkë me dokumentacionin që dispononi, mund t'i dërgoni pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me shqyrtimin e pretendimeve tuaja. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, mbetet i përkushtuar ndaj respektimit dhe angazhimit të zbatimit të parashikimeve kushtetuese, kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, për të respektuar dhe garantuar trajtim të paanshëm e objektiv në përmbushje të funksionit të rëndësishëm.		
51	17.03.2026	Kërkesë për informacion lidhur me një platformë elektronike që nuk menaxhohet nga ILD z. E.K (Orientim mbi kompetencën)	24.03.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, mbërritur me anë të postës elektronike pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe regjistruar me nr. 837/2 prot., datë 17.03.2026, përmes së cilës kërkoni informacion lidhur me platformën e-Albania, ju vënë në dijeni se: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Në përmbajtje të kërkesës suaj nuk ngrihen pretendime mbi veprimtarinë e ndonjë magjistrati, sikurse parashikohet në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nisur nga parashtrimi i mësipërm në funksion të zgjidhjes së çështjes dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në kërkesën tuaj, ju orientojmë që në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi t'i drejtoheni organeve kompetente, në rastin tuaj Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.		
52	17.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin ankesave të paraqitura nga shtetasja znj. G.P	24.03.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur me anë të postës elektronike dhe të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 856 prot., datë 17.03.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesat tuaja, ju vëmë në dijeni se:	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Sikurse jeni njoftuar bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesat tuaja janë në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kritereve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
53	18.03.2026	Kërkesë për informacion drejtuar një institucioni tjetër për dijeni ILD nga z. G.GJ (Orientim mbi kompetencën)	24.03.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur me anë të postës elektronike dhe të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 256/2 prot., datë 18.03.2026, përmes se cilës i drejtoheni Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ju vënë në dijeni se: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Në përmbajtje të kërkesës tuaj nuk ngrihen pretendime mbi veprimtarinë e ndonjë magjistrati, sikurse parashikohet në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nisur nga parashtrimi i mësipërm në funksion të zgjidhjes së çështjes dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në kërkesën tuaj, ju orientojmë që në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi t'i drejtoheni organeve kompetente, sikurse del qartë nga kjo kërkesë që i jeni drejtuar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.		
54	19.03.2026	Kërkesë për informacion mbi	27.03.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		ecurinë shqyrtimin ankesës të paraqitur nga shtetasi z. L.B		nr. 3/6 prot., datë 19.03.2026, përmes së cilës ngrini pretendime se nuk keni marrë përgjigje në lidhje me ankesën tuaj, ju vëmë në dijeni se: Për çdo kërkesë për informacion të depozituar nga ana juaj në vitin 2026, keni marrë përgjigje me shkresat nr. 3/1 prot., datë 08.01.2026, nr. 3/3 prot., datë 09.02.2026 dhe nr. 3/5 prot., datë 10.03.2026, në të cilat ju është bërë me dije se ankesa me nr. 324 prot., datë 06.02.2025, bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ndodhet në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Sikurse ju kemi vënë në dijeni në shkresat e sipërcituara, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
55	24.03.2026	Kërkesë për informacion lidhur me një kallzim penal që nuk është në kompetencë të ILD, nga z. S.G (Orientim mbi kompetencën)	27.03.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur me anë të postës elektronike dhe të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 906 prot., datë 24.03.2026, përmes së cilës kërkoni kopje dhe dokumentacionin shoqërues të vendimit penal me nr. 355, datë 11.02.2020, ju vëmë në dijeni se: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin	Përfunduar	Nuk ka

				e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Në përmbajtje të kërkesës tuaj nuk ngrihen pretendime mbi veprimtarinë e ndonjë magjistrati, sikurse parashikohet në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nisur nga parashtrimi i mësipërm në funksion të zgjidhjes së çështjes dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në kërkesën tuaj, ju orientojmë që në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi t'i drejtoheni organeve kompetente, sikurse del qartë nga kjo kërkesë që i jeni drejtuar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

56	25.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin ankesave të paraqitura nga shtetasi z. L.A	01.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur me anë të postës elektronike dhe të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 487/4 prot., datë 25.03.2026, përmes së cilës kërkoni informacion lidhur me trajtimin e ankesave tuaja, ju vëmë në dijeni se: Sikurse jeni njoftuar në vijimësi, bazuar në nenin 121, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesat nr. 1848 prot., datë 18.02.2025, nr. 3499 prot., datë 09.12.2025, nr. 3500 prot., datë 09.12.2025, nr. 3502 prot., datë 09.12.2025, nr. 3503 prot., datë 09.12.2025, nr. 3505 prot., datë 09.12.2025, si dhe nr. 335 prot., datë 30.01.2026, janë në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	Përfunduar	Nuk ka
57	25.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin ankesës të paraqitur nga shtetasi z. E.P	02.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj të mbërritur pëmes postës elektronike dhe të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 924 prot., datë 25.03.2026, nëpërmjet së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhen ankesat juaj, ju vëmë në dijeni se:	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesa juaj ndodhet në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kritereve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
58	27.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin ankesës të paraqitur nga znj. R.Gj	02.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj të mbërritur pëmes postës elektronike dhe të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 946 prot., datë 27.03.2026, nëpërmjet së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhen ankesat tuaja, ju vëmë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesat tuaja me nr. 765 prot., datë 06.03.2026, nr. 794	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				prot., datë 10.03.2026 dhe nr. 765/2 prot., datë 19.03.2026 janë në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuara në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
59	30.03.2026	Kërkesë për informacion lidhur me një efektiv policie që nuk është në kompetencë të ILD, nga z. A.B (Orientim mbi kompetencën)	03.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, mbërritur me anë të postës elektronike pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe regjistruar me nr. 953 prot., datë 30.03.2026, përmes së cilës ngrini pretendime mbi veprimtarinë e A.T., efektiv policie, ju vëmë në dijeni se: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Në përmbajtje të kërkesës suaj nuk ngrihen pretendime mbi veprimtarinë e ndonjë magjistrati, sikurse parashikohet në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				ndryshuar. Nisur nga parashtrimi i mësipërm në funksion të zgjidhjes së çështjes dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në kërkesën tuaj, ju orientojmë që në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi t'i drejtoheni organeve kompetente, në rastin tuaj Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP). Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.		
60	07.04.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin ankesës të paraqitur nga znj. E.GJ	16.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1086 prot., datë 07.04.2026, nëpërmjet së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesa e depozituar nga ana juaj me nr. 336 prot., datë 30.01.2026 ndodhet në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
61	07.04.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin ankesës të paraqitur nga z. D.G	16.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj të mbërritur përmes postës elektronike dhe të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1091 prot., datë 07.04.2026, nëpërmjet së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhen ankesat tuaja, ju vëmë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesat e depozituara nga ana juaj me nr. 611 prot., datë 23.02.2026 dhe nr. 611/1 prot., datë 23.02.2026 ndodhet në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	Përfunduar	Nuk ka
62	08.04.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin ankesës të paraqitur nga z. M.SH	16.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1103 prot., datë 08.04.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesa juaj me nr. 764 prot., datë 06.03.2026 është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
63	08.04.2026	Kërkesë për kopje dokumentacioni nga z. E.O	16.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1109 prot., datë 08.04.2026, me anë të së cilës kërkoni vënien në dispozicion të një kopje të ankesës nr. 553 prot., datë 18.02.2026, si dhe të çdo dokumentacioni shtesë të paraqitur në lidhje me këtë ankesë, ju vëmë në dijeni se bashkëlidhur shkresës po ju dërgojmë kopje të dokumentacionit të kërkuar.	Përfunduar	Nuk ka
64	10.04.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimit të ankesës së S.Sh., nga emisioni "V…" (Media)	20.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur përmes postës elektronike në datën 10.04.2026, nëpërmjet së cilës kërkoni informacion mbi ecurinë e trajtimit të ankesës së paraqitur nga ana e shtetasit z. S.Sh., ju vëmë në dijeni se kërkesa juaj është regjistruar me numër rendor 64 në regjistrin e posaçëm të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit dhe me numrin hyrës në regjistër nr. 1147 prot., datë 10.04.2026. Në lidhje me këtë kërkesë për informacion jeni të lutur të	Përfunduar	Nuk ka

				përdorni këtë numër regjistrimi për çdo korrespondencë në të ardhmen. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përgjatë zhvillimit të procedurave administrative i kushton një rëndësi të veçantë të drejtës së informimit të publikut në funksion të administrimit të drejtësisë sipas kërkesave të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, por në të njëjtën kohë duhet të garantojë edhe mbrojtjen e integritetit dhe figurën e subjekteve të procedurës administrative, mbrojtjes së interesave ligjore të personave të tretë, si dhe duhet të kujdeset që në kuadër të administrimit të të dhënave apo dokumenteve të mos cenojë funksionimin në vazhdim dhe qëllimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në të njëjtën kohë, në mbështetje të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", vetëm palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me fazën në të cilën ndodhet ankesa, si dhe me çdo vendim të marrë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Në rastin konkret, vendimmarrja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është njoftuar ankuesit në përputhje me parashikimet e nenit 121, pika		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				3 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Akti i njoftimit është shoqëruar me një kopje të vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe me njoftimin e të drejtës për të paraqitur ankim pranë Këshillit kompetent brenda një jave nga data e marrjes së kopjes së vendimit të arsyetuar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.		
65	20.04.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë dhe shqyrtimin e përshpejtuar të ankesës të paraqitur nga z. M.C	23.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1260 prot., datë 20.04.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj dhe përshpejtimin e trajtimit të pretendimeve të saj, ju vëmë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesa juaj është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Për sa i përket kërkesës suaj për përshpejtimin e trajtimit të ankesës tuaj me nr.3547 prot., datë 10.12.2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë	Përfunduar	Nuk ka

				zhvillon procesin e trajtimit të ankesave, shqyrtimin fillestar, verifikimin dhe hetimin disiplinor, në përputhje me parashikimet e Pjesës V, Kreu II të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke garantuar transparencë dhefikasitet në përpunimin e çështjeve të referuara. Në çdo rast Inspektori i Lartë i Drejtësisë, njofton vendimin e arsyetuar, sipas afateve të parashikuara në ligjin e sipërcituar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
66	20.04.2026	Kërkesë për kopje dokumentacioni nga z. A.A	21.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1246 prot., datë 20.04.2026, me anë të së cilës kërkoni vënien në dispozicion të një kopje dokumentacioni, ju vëmë në dijeni se bashkëlidhur shkresës po ju dërgojmë kopje të dokumentacionit të kërkuar.	Përfunduar	Nuk ka
67	21.04.2026 23.04.2026 06.05.2026	Tre (3) kërkesa për informacion me object të njëjtë, trajtuar në një shkresë. (Media)	06.05.2026	Në përgjigje të kërkesave tuaja, të mbërritura përmes postës elektronike, nëpërmjet të cilave kërkoni informacion nëse ka apo jo ankesa ndaj gjyqtarëve për vendosjen e pajustifikuar të arrestit në burg, ju vëmë në dijeni se kërkesat tuaja janë regjistruar me numër rendor 67 në regjistrin e posaçëm të kërkesave	Përfunduar	Nuk ka

				dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit dhe me numrin hyrës në regjistër nr. 1273 prot., datë 21.04.2026, nr. 1273/1 prot., datë 23.04.2026 dhe nr. 1273/2, datë 06.05.2026. Në lidhje me këto kërkesa për informacion jeni të lutur të përdorni këtë numër regjistrimi për çdo korrespondencë në të ardhmen. Sa i takon të dhënave të kërkuara nga ana juaj, paraprakisht vlerësohet se duke marrë në konsideratë natyrën e funksioneve të institucionit, sqarojmë se Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk është institucion me funksion statistikor dhe nuk përpunon apo prodhon statistika sipas kërkesave të individualizuara të subjekteve të interesuara. Megjithatë, të dhënat që grumbullohen dhe përpunohen në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së institucionit publikohen në mënyrë periodike në faqen zyrtare www.ild.al, si dhe në Buletinin informativ që publikohet çdo fillim muaji. Gjithashtu në faqen zyrtare të institucionit gjenden të publikuara edhe raportet e veprimtarisë së institucionit për periudhën 2020-2024, të cilat përmbajnë informacion të detajuar mbi ankesat e ardhura dhe të shqyrtuara, llojet e pretendimeve të ngritura në ankesa, hetimet e realizuara, kërkesat për procedim disiplinor dhecurinë e trajtimit të tyre në Këshillin e Lartë Gjyqësor apo në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Nga ana tjetër, sqarojmë se Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka planifikuar kryerjen e një inspektimi tematik me objekt: “Respektimi i		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				afateve të paraburgimit në kuadër të shuarjes së masave të sigurimit gjatë fazës së hetimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën 2023-2025", rezultatet e të cilit do të bëhen publike gjatë vitit 2026.		
68	21.04.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë dhe shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga z. M.A	23.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1270 prot., datë 21.04.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhen ankesat tuaja, ju vëmë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesat tuaja janë në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kritereve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
69	21.04.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë dhe shqyrtimin e ankesës dhe arsyet e vonesave në trajtimin e saj të paraqitur nga z. L.B	29.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur me anë të postës elektronike dhe të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 3/9 prot., datë 21.04.2026, përmes së cilës ngrini pretendime se nuk keni marrë përgjigje në lidhje me ankesën tuaj, ju vëmë në dijeni se: Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar në mënyrë shteruese pretendimet e ngritura në ankesat tuaja, të regjistruara me nr. 55 prot., datë 10.02.2020 dhe nr. 55/2 prot., datë 18.05.2020. Në përfundim të verifikimit, me vendimin nr. 701/1 prot., datë 20.04.2023, me lëndë : "Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura…", është vendosur arkivimi i ankesave tuaja. Për këtë vendimmarrje jeni vënë në dijeni me shkresën nr. 701/2 prot., datë 20.04.2023, me lëndë: "Njoftim mbi vendimin e arkivimit pas verifikimit të ankesave te bashkuara". Sa i përket ankesës tjetër të depozituar prej jush, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shkak të ngarkesës së konsiderueshme në ushtrimin e veprimtarisë së saj lidhur me trajtimin e ankesave të depozituara pranë institucionit përgjatë periudhës së funksionimit, bën me dije se, për rastin konkret, deri në këtë fazë nuk është nxjerrë ende ndonjë akt procedural e për rrjedhojë	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				mbetet në fazë vlerësimi. Gjithashtu, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ndjek një rend shqyrtimi të ankesave, duke marrë në konsideratë ankesat që kanë afate të përshpejtuara shqyrtimi për shkak të rrezikut të parashkrimit, tipologjisë së çështjes, nivelit të urgjencës së trajtimit, si dhe kriterit kronologjik të datës së paraqitjes së tyre. Në përfundim të procedurës administrative, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
70	22.04.2026	Kërkesë për takim për ecurinë dhe shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga znj. M.M	23.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me nr. 225/7 prot., datë 22.04.2026, përmes së cilës kërkoni takim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, ju vëmë në dijeni se: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Për sa i përket kërkesës tuaj për të zhvilluar një takim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nuk parashikon në këtë moment procedural takim midis ankuesit dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sikurse jeni në dijeni, ju keni zhvilluar takim me përfaqësues të Sektorit të Ndihmës dhe Koordinimit të Informacionit, më datat 23.01.2026, 29.01.2026, 06.02.2026 dhe 24.02.2026, në të cilat keni marrë informacion të plotë dhe të detajuar rreth kompetencave, afateve dhe proceset nëpërmjet të cilave kalon shqyrtimi i ankesave nga momenti i depozitimit, deri në daljen me vendim nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, ju mund të paraqiteni sërish pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, çdo ditë nga ora 09:00, deri në orën 14:00, për t'u takuar me përfaqësues të Sektorit të Ndihmës dhe Koordinimit të Informacionit.		
71	22.04.2026	Kërkesë për takim për ecurinë dhe shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga z. E.G	27.04.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 628/2 prot., datë 22.04.2026, nëpërmjet së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaja, ju vënë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesa	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				juaj me nr. 628 prot., datë 24.02.2026 është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuara në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
72	24.04.2025	Kërkesë sqaruese mbi për ecurinë dhe shqyrtimin e disa ankesave dhe shkresave paraqitur nga znj. L.C; z. Sh.D dhe z. F.D	07.05.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1084/5 prot., datë 24.04.2025, përmes së cilës kërkoni sqarim në lidhje me ankesat e regjistruara me nr. 1084 prot., datë 07.04.2026, nr. 1084/1 prot., datë 07.04.2026 dhe 1084/2 prot., datë 20.04.2026, ju bëjmë me dije se: Ankesat e përcjella nga ana juaj së fundmi, janë konfirmuar në respektim të parashikimeve ligjore lidhur me konfirmimin për marrjen e ankesës sipas përcaktimeve të bëra në nenin 119 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Pavarësisht cilësimit të bërë nga ana juaj, për dokumentet e përcjella, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mund të bëhet një cilësim i ndryshëm e rrjedhimisht procedohet me konfirmimin e marrjes së ankesës kur është rasti. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton çdo ankesë përmes një vlerësimi paraprak për të konstatuar nëse ka elementë që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magjistratëve.	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Ky proces zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, që rregullon procedurat për shqyrtimin dhe hetimin e tyre. Në funksion të shqyrtimit të pretendimeve në mënyrë të unifikuar, pavarësisht se pretendimet tuaja, janë paraqitur në periudha të ndryshme Inspektori i Lartë i Drejtësisë siguron se gjatë analizimit të rastit verifikohen të gjitha pretendimet e ngritura ndaj një ose më shumë magjistratëve, apo për të njëjtat fakte. Kjo pasi në përputhje me parashikimet e nenit 128 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet shqyrtimi i bashkuar i ankesave apo hetimit, kur ato u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat. Sikundër mund të procedohet edhe me veçimin e një pretendimi dhe regjistrimin me numër të ri, në funksion të ndjekjes së një rruge krejt të ndryshme procedurale. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si pjesë e organeve shtetërore që i nënshtrohet kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndjek dhe zbaton parashikimet e ligjit për arkivat, i cili dikton rregulla të njëtrajtshme sa i takon përpunimin tekniko shkencor të dokumenteve, në bazë të kritereve arkivore, ku ndër të tjera renditet edhe kronologjia gjatë një viti. Në përfundim të vitit dhe nëse praktika nuk ka përfunduar ajo fillon me numër të ri të plotë, por pa humbur		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				gjurmueshmërinë e tij ndër vite, e në këto kushte, sigurojmë që numrat janë të lidhur në regjistrat e korrespondencës. Lidhur me shkresat tona nr. 1084/3, datë 20.04.2026 dhe 1084/4, datë 20.04.2026, sa i takon numrave të protokollit, konstatojmë një gabim njerëzor në renditjen e fraksioneve, prandaj edhe bashkëlidhur kësaj kthim përgjigje do të rigjeni konfirmimet përkatëse. Për sa më sipër, në respektim të kuadrit ligjor të sipërpërmendur, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
73	27.04.2025	Kërkesë për informacion për ecurinë dhe shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga z. E.P	04.05.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1354 prot., datë 27.04.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesa juaj është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kritereve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
74	29.04.2025	Kërkesë për informacion nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka regjistruar, apo jo procedim disiplinor ndaj një anëtari të Këshillit të Lartë të Prokurorisë E.K	13.05.2026	Në vijim të kërkesës suaj, nëpërmjet të cilës kërkohet informacion nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka regjistruar, apo jo procedim disiplinor ndaj një anëtari të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ju vëmë në dijeni se Zyra e Inspektorit të Lartë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konfirmon marrjen e saj në datën 29.04.2026. Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon se kërkesa juaj është regjistruar me numër rendor 74 në regjistrin e posaçëm të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit dhe me numrin hyrës në regjistër nr. 1390 prot., datë 29.04.2026. Në këtë kuadër, në lidhje me këtë kërkesë për informacion jeni të lutur të përdorni këtë numër regjistrimi në çdo korrespondencë në të ardhmen.	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Inspektori i Lartë i Drejtësisë përgjatë zhvillimit të procedurave administrative i kushton një rëndësi të veçantë të drejtës së informimit të publikut në funksion të administrimit të drejtësisë sipas kërkesave të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, por në të njëjtën kohë duhet të garantojë edhe mbrojtjen e integritetit dhe figurën e subjekteve të procedurës administrative, mbrojtjes së interesave ligjore të personave të tretë, si dhe duhet të kujdeset që në kuadër të administrimit të të dhënave apo dokumenteve të mos cenojë funksionimin në vazhdim dhe qëllimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të organit publik. Në këtë kuadër, paraprakisht vlerësohet se në këtë moment informacioni i vetëm, i cili mund t`ju vihet në dispozicion është se informacionet e bëra publike ndaj sjelljes së një anëtari të Këshillit të Lartë të Prokurorisë po shqyrtohen dhe vlerësohen nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 96/2016		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.		
75	29.04.2025	Kërkesë për informacion për ecurinë dhe shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga znj. V.C	04.05.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1396 prot., datë 29.04.2026, nëpërmjet së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesa e depozituar nga ana juaj me nr. 619 prot., datë 23.02.2026 ndodhet në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	Përfunduar	Nuk ka
76	30.04.2025	Kërkesë për takim mbi kompetencat dhe takim me titullarin e institucionit të paraqitur nga znj. Sh.B	07.05.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me nr. 1410 prot., datë 30.04.2026, përmes së cilës kërkoni takim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, ju vëmë në dijeni se: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Përsa i përket kërkesës tuaj për takim, ju mund të paraqiteni pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, çdo ditë nga ora 09:00, deri në orën 14:00, për t'u takuar me përfaqësues të Sektorit të Ndihmës dhe Koordinimit të Informacionit në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.		
77	30.04.2025	Kërkesë për informacion për ecurinë dhe shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga z. L.B	07.05.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 3/11 prot., datë 30.04.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesat tuaja, ju vëmë në dijeni se: Ju keni depozituar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 3 (tre) ankesa të regjistruara konkretisht me nr. 2942 prot., datë 21.10.2025,	Përfunduar	Nuk ka

				nr. 2942/2 prot., datë 18.11.2025 dhe nr. 324 prot., datë 06.02.2025, për të cilat jeni njoftuar me konfirmimet përkatëse përmes postës elektronike. Për vitin 2026 jeni njoftuar me shkresat me nr. 3/1 prot., datë 08.01.2026, nr. 3/3 prot., datë 09.02.2026, nr. 3/5 prot., datë 10.03.2026, dhe nr. 3/10 prot., datë 29.04.2026, në përputhje me parashikimet e nenit 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbi fazën procedurale në të cilën ndodhen ankesat tuaja, të cilat janë në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Sikurse jeni në dijeni për ankesat tuaja të mëparshme, ju është njoftuar vendimmarrja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 701/2 prot., datë 20.04.2023, me lëndë: "Njoftim mbi vendimin e arkivimit pas verifikimit të ankesave te bashkuara". Akti i njoftimit është shoqëruar me një kopje të vendimit nr. 701/1 prot., datë 20.04.2023 dhe me njoftimin e të drejtës për të paraqitur ankim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda një jave nga data e marrjes së kopjes së vendimit të arsyetuar. Për ankesat që janë në proces shqyrtimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		
78	06.05.2026	Kërkesë për informacion për ecurinë dhe shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga z. A.L	13.05.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1456 prot., datë 06.05.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhen ankesat tuaja, ju vëmë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesat tuaja ndodhen në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kritereve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	Përfunduar	Nuk ka
79	07.05.2026	Kërkesë për informacion për	13.05.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me	Përfunduar	Nuk ka

		vendimmarrjen pas shqyrtimit të ankesës paraqitur nga z. A.V		nr. 1473 prot., datë 07.05.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhen ankesat tuaja, ju vëmë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, lidhur me ankesat tuaja me nr. 521 prot., datë 20.02.2024 dhe nr. 2166/7 prot., datë 20.10.2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet e paraqitura dhe, me vendimin nr. 1496 prot., datë 08.05.2026, ka vendosur "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi Aurel Vogli". Për këtë vendimmarrje, jeni njoftuar me shkresën nr. 1496/1 prot., datë 08.05.2026. Për shkak se në ankesat tuaja, ngrihen pretendime të ndryshme ndaj disa magjistratëve, shqyrtimi i tyre ndodhet në faza të ndryshme të trajtimit procedural në përputhje me parashikimet e Pjesës V, Kreu II, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

80	11.05.2026	Kërkesë për informacion për ecurinë dhe shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga z. D.G	13.05.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 611/7 prot., datë 11.05.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhen ankesat tuaja, ju vëmë në dijeni se: Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesat e depozituara nga ana juaj me nr. 611 prot., datë 02.03.2026, 611/1 prot., datë 23.02.2026, 611/3 prot., datë 20.04.2026 dhe 611/5 prot., datë 04.05.2026, ndodhen në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	Përfunduar	Nuk ka
